

Si mund të përdor e-banking/m-banking në mënyrë të sigurt?

Banka ProCredit është e angazhuar për të ofruar sigurinë e nevojshme në kryerjen e transaksioneve bankare online si dhe mbrojtur të dhënat e llogarive tuaja. Për ta përbushur këtë, ProCredit Bank përdor programin më të fundit të sigurisë si dhe ka implementuar procese të shumta sigurie. Pavarësisht kësaj, ju duhet të dini se Interneti dhe e-mail-et mund të përdoren si mjete për qëllime dhe aktivitete joligjore. Për këtë arsye ne gjithmonë ju këshillojmë të merrni disa masa të thjeshta në mënyrë që të jeni sa më të sigurt gjatë kryerjes së transaksioneve të ndryshme bankare.

Këshilla për të qenë të sigurt online

› Të dish se me cilin ke të bësh

Gjithmonë aksesoni e-banking duke shtypur adresën e bankës <https://ebanking.procreditbank.com.al> në browserin tuaj, ose përdorni m-banking duke hyrë në aplikacionin zyrtar.

Mos hyni në e-banking/m-banking, duke klikuar në një link që ju është dërguar me e-mail, dhe asnjëherë mos vendosni të dhënat tuaja personale në këtë link. Për çdo informacion që mund t'ju duket i dyshimtë, ju lutem kontaktoni me Qendrën e Kontaktit të ProCredit Bank +355 4 2 389 389.

› Ruani password-in në një vend të sigurt

Gjithmonë bëni kujdes me e-mail-et dhe telefonatat në të cilat ju kërkohet të jepni informacione personale, për shembull: numrin e kartës suaj të debitit/kreditit. ProCredit Bank ose policia nuk do ju kontaktojnë asnjëherë duke ju kërkuar të jepni informacionin për passwordin tuaj. Mbajini sekret këto të dhëna. Bëni kujdes për të mos ja dhëne këtë informacion asnjë personi, sidomos nëse nuk e njihni personin në fjalë.

› Mbani të sigurta pajisjet tuaja elektronike

Gjithmonë përdorni një anti-virus i cili është i përditësuar me versionin më të fundit dhe instaloni një firewall personal. Browseri përmes të cilit futeni në Internet duhet të jetë versioni më i fundit dhe të përmbajë të gjitha përditësimet e sigurisë. Mbi të gjitha, bëni një kujdes të veçantë, kur e përdorni internetin nga Internet Café, në vende publike ose kur nuk po përdorni kompjuterin/telefonin tuaj.

› Kini kujdes paratë tuaja

Mos u genjeni nga e-maile në dukje të singerta, të cilat ju ofrojnë mundësinë të bëni para lehtësisht. Nëse ju duket “shumë e bukur për të qenë e vërtetë”, me siguri është ashtu. Bëni veçanërisht kujdes me e-mailet që ju vijnë nga jashtë, pasi për këto e-maile është shumë e vështirë të vërtetohet nëse dërguesi është ai që thotë se është¹.

Për më shumë informacion ju mund t'i referoheni faqes zyrtare të specialistëve të sigurisë online: <http://www.staysafeonline.org/stay-safe-online>

¹ Ju lutemi referojuni dokumentit “Si mund të mbrohem nga phishing?” të publikuar në faqen e e-banking, në website të bankës.

Masa shtesë


› Sigurohuni që po përdorni aplikacionin zyrtar të bankës

Një nga mënyrat më të sigurta për të kryer veprime bankare është përmes aplikacionit mobile zyrtar të bankës. Për këtë qëllim, ju mund të përdorni edhe web browser, por aplikacioni ju siguron nivel të avancuar enkriptimi.

› Gjithmonë sigurohu që të njohësh personin me të cilin po komunikon

- Përpara se të vendosni çdo informacion, gjithmonë kontrolloni që të jetë ikona e drynit në pjesën e sipërme të fushës ku shkruhet emri i faqes që po futeni. Nëse faqja ku po futeni është e sigurt, ju do të shikoni që adresa e bankës do të ndryshojë nga “http” në “https”.
- Ju mund të siguroheni për certifikatën e sigurisë së ProCredit Bank, duke klikuar tek ikona e drynit që shfaqet në pjesën e sipërme të fushës ku shkruhet emri i faqes.


Mozilla Firefox:



Internet Explorer:



Google Chrome:



› Ruani password-in në mënyrë të sigurt

- Gjithmonë memorizoni password-et tuaja dhe çdo informacion tjetër sigurie. Shkatërroni çdo dokument me të cilin ju është sjelle ky informacion për të evituar mundësitë e përdorimit të këtij informacioni nga palë të tjera.
- Ndërmerrni hapat e nevojshëm për të ruajtur password-in dhe informacionin e sigurisë. Mos ja jepni këtë informacion asnjë të afermi të familjes, miqve tuaj apo çdokujt tjetër.
- Në momentin që telefononi bankën, duhet të dini që banka nuk do ju kërkojë asnjëherë passwordin tuaj nëpërmjet telefonit.
- Sigurohuni që të beni “log out” në mënyrën e duhur nga e-banking/m-banking pasi keni përfunduar transaksionet tuaja.
- Asnjëherë mos e ruani passwordin në kompjuterin tuaj (nëpërmjet password manager). Këtë mund ta bëni vetëm nëse jeni të sigurt që kompjuteri juaj është plotësisht i mbrojtur.
- Mos u largoni nga pajisjet tuaja elektronike gjatë kohës që jeni të log-uar në e-banking/m-banking.
- Ne ju rekomandojmë të ndryshoni passwordin tuaj vazhdimisht. Gjithmonë zgjidhni një password i cili nuk mund të gjendet lehtë.
- Mos e përdorni password-in e e-banking/m-banking në faqe të tjera interneti.

Masa shtesë

› Mbroni pajisjet tuaja elektronike

- Bëni kujdes nga e-mail që ju vijnë nga persona që nuk i njihni, dhe asnjëherë mos klikoni në linqet që ndodhen në këto e-maile për të aksesuar ndonjë faqe interneti.
- Asnjëherë mos hapni, shkarkoni apo ekzekutoni dokumenta që ndodhen të bashkangjitur në një e-mail të dërguar nga një i panjohur, që ju duket i dyshimtë, apo që ju vjen nga një burim i pabesueshëm.
- Instaloni program anti-virusi, mbajeni gjithmonë të përditesuar dhe bëni në menyrë të rregullt skanime sigurie. Instaloni përditesimet e fundit të sigurisë, të cilat në terma teknike informatike quhen “patches”.

Çdo veprim i cili nuk ngjan me veprimet që ju bëni zakonisht në m-banking, duhet ta shikoni si të dyshimtë. Në momentin që keni një dyshim, kontaktoni me ProCredit Bank duke vizituar një nga pikat tona të shërbimit, kontaktoni këshilluesin tuaj ose telefononi Qendrën e Kontaktit të ProCredit Bank +355 4 2 389 389.